



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT/OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazno

Nr. X-491
Br.

Data 17.08.2020
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opstina Obilic/Municipality of Obilic

Drejtoria e Arsimit

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ,nr.04/L-032 , Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, me nr.22/2013, vendimin nga MASH nr.01/B ,Nr.1771,datë 06.08.2020, Drejtoria për Arsim, më 17.08.2020, shpall :

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2020-2021, sipas Konizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK)

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjimnazin “17 Shkurti” në Obiliq dhe SHMLP “Isamil Dumoshi” në Obiliq për vitin shkollor 2020-2021, mund të konkurrojnë kandidatët , të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Republikës së Kosovës , obligohen ta bëjnë njohjen e certifikatave ose dëftesave në MASH, pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe në shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente :

- Fletëparaqitjen, e cila do të merret në shkollën, në të cilën konkurron,
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9)
- Certifikatën e lindjes.

Sqarim: Shkollat duhet të krijojnë kushte për mbajtjen e distancës së nxënësve gjatë konkurrimit të tyre.

3.Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Dorëzimi i dokumenteve për gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2020/2021 , bëhet me datat:17-21 gusht 2020, në lokalet e shkollës, ku nxënësit dëshirojnë të regjistrohen, duke filluar nga ora 8.00 -16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve do të shpallen në shkollat përkatëse me datën 24.08.2020 (në shkollat ,ku plotësohet numri i nxënësve).

Në shkollat ku nuk plotësohet numri i nxënësve, konkurrimi i nxënësve mund të vazhdojë deri më 26.08.2020.

Shpallja e rezultateve më 28.08.2020, (në shkollat ,ku nuk plotësohet numri i nxënësve dhe vazhdon konkurrimi).

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 24-31 gusht 2020.

Kandidati i refuzuar, i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë ankese , brenda 24 orëve , nga koha e shpalljes së rezultateve t`i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit,dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASH-it, te komisioni për ankesa.

4.Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t`i plotësojë këto kriteret :

- 1.Nota mesatare e të gjitha lëndëve (klasa 6-9).....(60%) 60 pikë
2. Nota mesatare nga lëndët prioritare (klasa 6-9).....(40%) 40 pikë
- 3.Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaz dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë katër e më lartë (së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve priotitare veç e veç , pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve.

5.Renditja e lëndëve me prioritetet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi i shkencave të natyrës:

1. Lënda :Fizikë
2. Lënda :Kimi
3. Lënda:Biologji
4. Lënda :Matematikë

II. Gjimnazi i shkencave shoqëror dhe gjuhësore :

- 1.Lënda :Gjuhë amtare
- 2.Lënda :Gjuhë angleze
- 3.Lënda:Histori
- 4.Lënda :Gjeografi

Renditja e lëndëve me prioritetet sipas profileve në shkollën profesionale

I.Makineri , Elektroteknikë , Kimi-Teknologji dhe Xehtari

1. Lënda :Fizikë
- 2.Lënda :Kimi
- 3.Lënda:Matematikë
- 4.Lënda :TIK

II. Ekonomi (banka dhe financa)

- 1.Lënda :Gjuhë amtare
- 2.Lënda :Gjeografi
- 3.Lënda:Matematikë
- 4.Lënda :TIK

• Gjimnazi “ 17 Shkurti “ në Obiliq

Nr.	Drejtimi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1.	Gjimnazi Natyror	2	64
2.	Gjimnazi shoqëror	1	32
Gjithsej:		3	96

• SHMLP “ Ismail Dumoshi“në Obiliq

Nr.	Drejtimi	Profili	Nr.i paraleleve	Nr.i nxënësve	Vitet e shkolli mit
1.	Elektroteknikë	Telekomunikacin	1	32	2+1
		Informatikë	1	32	2+1
		Energjetikë	2	64	2+1
2.	Makineri	Operator prodhimi	1	32	2+1
3.		Laborant i kimisë	1	32	2+1
		Gjeologji	1	32	2+1
4.	XEHTARI	Xehtari	1	32	2+1
5.	EKONOMI	Banka dhe financa	1	32	2+1
Gjithsej:			9	288	2+1

Drejtori i DA-së: Rexhep Zeka

